

Syllabusi i lëndës

Lënda: Hadith IV - *Dispozitat e Hadithit*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 5

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 403

Fondi i orëve: 2+2

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: VIII

Mësimdhënësi: Prof. ass. Dr. Musa Vila

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Kjo lende ka te beje me Hadithet qe përmbajnë rregulla mësim dhe norma te përgjithshme te legjislacionit fetar dhe juridik. Ku ne mesin e temave qe trajtohen janë, e drejta civile, qe përfshin çështjen e martesës dhe dispozitat e saj, shkurorëzimin me dispozitat e tij, e drejta penale qe përmban çështjet e kriminalitetit, ndëshkimet, si dhe përcaktimi i marrëdhënieve midis fajtorit, dorasit dhe viktimës. Po ashtu hadithet qe kanë te bëjnë rreth ushqimeve te pastra mishrat, gjuetinë dhe kafshët qe lejohen për ngrënie. Gjithashtu kjo përmban Hadithet qe kanë te bëjnë me ndëshkimet, zotimet, dëshmitë, pretendimet etj.

Qëllimi i lëndës

Kjo lëndë ka për qëllim që t'i njoftojë studentët lidhur me dispozitat e Hadithit, kuptimin dhe mendimet e dijetarëve, duke bërë krahasime se cila prej tyre është më e fuqishme. Mandej i ofrohet në mënyrë shkencore forma e dispozitave që mund të nxirren nga hadithet. Mendimet e katër drejttimeve lidhur me dispozitat e hadithit, duke cekur argumentimin e tyre, kundër argumentimin si dhe polemikat që ndërliken me hadithin. Gjithashtu studentët nga për së afërmi do të njihen me tekstet origjinale të gjuhës arabe ku do të kenë rastin t'i lexojnë dhe t'i shqiptojnë në mënyrë të drejtë. Ndër tematikat kryesore që do të njoftohen studentët janë hadithet që përmbajnë rregulla, mësim dhe norma të edukatës. Trajtohen dispozitat e martesës dhe shkurorëzimit që janë pjesë përbërëse e gjendjes civile. Po ashtu do të njoftohen me hadithet që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe dispozitat penale, hadithet rreth ndëshkimeve dhe qortimeve. Si dhe hadithet që kanë të bëjnë me ushqimet, gjuetinë dhe kafshët që dedikohen për therje.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas perfundimit te ketij kursi student do te jete ne gjendje:

1. Te pershkruaj historikun e zhvillimit te hadithit nga koha e Muhamedit a.s deri ne etapen e kodifikimit ne libra, qe me von do te jene baze ne argumentim.
2. Te krahasoj punen e palodhshme te dijetareve te hadithit dhe studiuesve te sotit.
3. Te diskutoj formen me te pershtatshme per implementimin e haditheve ne jeten praktike.
4. Te mbroj theniet profetike nga dyshimet dhe akuzat qe mund ti veshen thenieve te shenjta.
5. Te prezentoj nje pasqyre te shkurter se si praktikisht studiuesi mund te arrin tek burimi I thenieve profetike ne koleksionet e hadithit.
6. Te memorizoj nje numer te konsiderueshem te thenjeve profetike ashtu siq I ka thene vete Profeti tekstualisht ne gjuhen arabe me perkthim ne gjuhen shqipe.

Metodologjia e mësimdhënies:

1. Mësimi do te zhvillohet ne forme te ligjeratave, ushtrimeve dhe diskutimeve interaktive.
2. Stimulimi i studenteve ne diskutime interaktive, duke perfituar formen me te pershtatshme te argumentimit me theniet profetike .
3. Do te ket shkembim te ideve ne formen e diskutimit duke pranuar edhe mendimin ndryshe e qe do ti nxit studentet qe te jene me aktiv gjat ligjeratave .
4. Ne aspektin e praktikes mesimdhenesi do të zbresë se bashku me studentet ne biblioteken e fakulltetit dhe do te njihemi me librat baze te hadithit , te spjegimit te hadithit , të dispozitave dhe normave te hadithit , si dhe metodologjinë shkencore te hadithologeve .

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

1. Veprat çmohen sipas qëllimit. 2. Llojet e nijetit sipas hadithit. 3. Kuptimi i hadithit dhe nocioni ed-dunja.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.11-27)

Java e dytë:

1. Çështja e hallallit, haramit dhe dyshimit në Islam. 2. Definicionet e tyre. 3. Llojet e dyshimeve.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.28-38)

Java e tretë:

1. Hadithi që tregon se këshilla është element thelbësor i fesë. 2. Këshillat e Zotit dhe të Librit të Tij. 3. Këshillat e të Dërguarit të Zotit dhe këshillat e udhëheqësve dhe besimtarëve.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.39-47)

Java e katërt:

1. Feja sintezë e pastërtisë trupore dhe shpirtërore. 2. Namazi dhe lëmosha në këndvështrimin e Hadithit. 3. Durimi në këndvështrimin e Hadithit.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.48-59)

Java e pestë:

1. Porositë profetike për rininë. 2. Adhurimi dhe ndihma i dedikohet vetëm Zotit. 3. Besimi në përcaktimin e Allahut sipas Hadithit.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.60-72)

Java e gjashtë:

1. Hadithi që tregon për unitetin e shoqërisë. 2. Shmangia nga përgjimi i njëri-tjetrit. 3. Shmangia nga spiunimi për njëri-tjetrin. 4. Ruajtja nga zilia dhe tradhëtia.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.73-82)

Java e shtatë:

1. Etapat e krijimit të njeriut në thëniet profetike. 2. Kohëzgjatja e këtyre etapave. 3. Dhurimi i shpirtit tek fetusit. 4. Çka është shpirti dhe mendimet e dijetarëve.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.83-100)

Java e tetë:

1. Kurorëzimi, martesë domosdoshmëri e jetës. 2. Martesë traditë e të Dërguarit a.s. 3. Cili është synimi i martesës.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.101-124)

Java e nëntë:

1. Fejesa dhe mënyra e saj. 2. Bashkëshortët duhet ta shohin njëri-tjetrin. 3. Femra muslimane është e lirë ta zgjedhë bashkëshortin. 4. Martesë e përkohshme.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.125-155)

Java e dhjetë:

1. Kapitulli i shkurorëzimit. 2. Ndarja e gruas nga burri me kompensim. 3. Shkurorëzimi me mallkim. 4. Atësia e fëmijës nuk mohohet pa fakte.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.157-187)

Java e njëmbëdhjetë:

1. Veprat penale – kriminaliteti. 2. Kur lejohet gjaku i muslimanit – ekzekutimi. 3. Lufta kundër rebelizmit. 4. Ekzekutimi i dezertorit. 5. A është i lejuar gjaku i cili e fyen të Dërguarin a.s.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.191-228)

Java e dymbëdhjetë:

1. Ndëshkimet dhe qortimet. 2. Ndëshkimi për prostitucion. 3. Pranimi i fajit për prostitucion. 4. Dispozitat e Hadithit dhe mendimet e dijetarëve.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.230-249)

Java e trembëdhjetë:

1. Ndëshkimi për shpifje. 2. Ndëshkimi për vjedhje. 3. Ndëshkimi për alkool. 4. Qortimet dhe format e tyre.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.250-300)

Java e katërbëdhjetë:

1. Ushqimi, gjuetia, kafshët që lejohet t’u hahet mishi dhe ato për kurban. 2. Vendimet për kafshët mishngrënëse. 3. A lejohet të hahet mishi i gomarit të egër dhe mishi i kalit. 4. Përmendja e emrit të Allahut në prerje.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.301-321)

Java e pesëmbëdhjetë:

1. Mjetet e prerjes dhe cilat prej venave të kafshës duhet të pritët. 2. Çka është e preferuar te kurbanin. 3. Mangësitë që e bëjnë të pavlefshëm kurbanin. 4. Nuk lejohet asgjë nga kurbanin të shitet.

Literatura: (“Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”, fq.322-333)

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr. ass. Musa Vila, “Komentimi i haditheve sipas metodologjisë shkencore”. Prishtinë 2014.
2. Dr. Jusuf Kardavi, “Hallalli dhe Harami në Islam”, Prishtinë 2002.
3. Dr. Kahtan Abdurrahman Ed-Duri, “Safvetul ahkam min nejlil eutari ve subul es-selami”, Amman, 1999.
4. Dr.Musa Vila, ”Nën hijen e haditheve të Resulullahut, FIS, Prishtinë, 2018”
5. Tahaviu,Ebu-Xhafer,Ahmed Ibn Muhamed “Sherrh Meanil Athar” “Dar Kutub El Ilmije”,Beirut 1994

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Muhamed El-Uthejmini, “Komentari i librit – Rijadus-salihinë”, Prizren 2013.
2. Dr.ass. Musa Vila, “Veprimtaria e Ahmed ef. Kaleshit në fushën e Hadithit”, Prishtinë 2012.
3. Muhamed El-Gazali, “Es-sune en-nebevije bejnel ehlil fikhi ve ehli hadith”, Bejrut, 1989.
4. Imam Tirmidhi, “Virtytet e të Dërguarit s.a.v.s.”, Shkup, 2002.
5. Muhamed Axhaxhë, El-Hatibë, “Shkëndia nga udhëzimi Profetik”, Prizren, 1997.
6. Fet’hul Bari fi sherh sahih el buhari, Ibn Haxher el Askalani, dar etturath el arabi, Bejrut, 1976.
7. Zejlai,Xhemaludin Abdullah Ibn Jusuf, “Nasbu Rrajeh”, “Muesese Errejan”,Beirut 1997